



PROCESVERBALI

Nga mbledhja e rregullt e Kuvendit Komunal të Rahovecit, e mbajtur më **23.07.2015 (e enjte)** me fillim në ora **10.15**. Mbledhjen e kryesoi kryesuesi i Kuvendit **Nahit Elshani**.

Kryesuesi Elshani – Fillimisht më lejoni të përshëndes Nënkryetarin e komunës z. Xhemali Haxhimustafa dhe stafin e tij, delegatët e pranishëm në këtë seancë, përfaqësuesit e OSBE-së, monitoruesin e KDI-së, Monitoruesit e KFORIT, përfaqësuesit e mediave dhe të gjithë të pranishmit e tjerë. Nëse ka ndonjë prej delegatëve të nderuar që ta arsyetojë mungesën në mbledhjen e kaluar?

Rend Dite

1. Aprovimi i Procesverbalit nga mbledhja e kaluar,
2. Shqyrtimi dhe aprovimi Raportit Financiar për realizimin e buxhetit komunal për periudhën **Janar – Qershor 2015**,
3. Shqyrtimi dhe aprovimi i propozim Vendimit sipas kërkesës të Këshillit të fshatit Hoçë e Madhe për shpalljen e pavlefshme të Vendimit 01 Nr.125/07 të datës 26.06.2007,
4. Shqyrtimi dhe aprovimi i Raportit të punës dhe financiar për periudhën e sezonit pranveror të klubeve në komunën e Rahovecit,
5. Raporti i Komisionit Komunal për zgjedhjen e Këshillave dhe Kryetarëve të fshatrave, vendbanimeve të lagjeve urbane në komunën e Rahovecit,
6. Pyetje dhe përgjigjet në pyetjet e këshilltarëve.

Kryesuesi – E keni marr edhe një material shtesë që është Raporti i Komisionit për Zgjedhjen e Këshillave të Fshatrave dhe Lagjeve të Qytetit, besoj se do të pajtoheni që të jetë edhe kjo si pikë shtesë e rendit të ditës.

Florije Boshnjaku - Në mbledhjen e kaluar ka qenë një pikë për kamp shtëpizat tek ura e shenjt dhe ne kemi propozuar që të jetë në këtë mbledhje, por sot nuk e kemi. Po ashtu pikë tjetër që është dashur të jetë sot është edhe pika për ndriçimin publik, që Kryetari e propozoj që të shtyhet për seancën e radhës, dua ta di se këto dy pika a janë pa afat sepse mendoj se janë pika me rëndësi dhe duhet të na servohen neve.

Kryesuesi – Së pari unë nuk e qes asnjë pikë në rend të ditës pa ardhur raporti i komisionit për vlerësimin e gjendjes. Raporti për kamp shtëpizave nuk ka ardhur, por besoj se drejtori do të na shpjegoj shkakun. Ndërsa çështja e ndriçimit publikë është çështje që Kryetarit dhe ai është duke bërë konsulta me zyrën e prokurimit.

Avdullah Kryeziu – Kam kërkuar unë nga Kryesuesi që kjo pikë e rendit të ditës mos të jetë në këtë mbledhje por në mbledhjen e ardhshme për arsye se atëherë do të jete i gatshëm edhe procesverbali i gjendjes së atyre kamp shtëpive.

Kryesuesi – E qesë në aprovim rendin e ditës me pikën shtesë që është Raporti i Komisionit për Zgjedhjen e Këshillave të Fshatrave dhe Lagjeve Urbane. Kush është për: konstatoj që në mënyrë unanime është aprovuar rendi i ditës.

1. Aprovimi i Procesverbalit nga mbledhja e kaluar.

Rukije Krasniqi – Tek citimi i Fatmirit në lidhje me pagesat e mëditjeve për emërtimin e rrugëve dhe shesheve, nënkryetari ka thane se ky komision ka vepruar gjatë orarit të punës. Sa e di unë ky komision ka vepruar pas orarit të punës dhe nuk janë paguar 3 anëtarë nga këshilli ekzekutiv i atëhershëm.

Kryesuesi - E qesë në aprovim procesverbalin: Konstatoj që në mënyrë unanime është aprovuar Procesverbali.

2. Shqyrtimi dhe aprovimi i Raportit Financiar për realizimin e buxhetit komunal për periudhën **Janar – Qershor 2015**.

Lulzim Sylejmani – Para jush kemi prezantuar Raportin për realizimin e Buxhetit komunal për periudhën Janar – Qershor 2015, duke bërë një krahasim me periudhën e vitit 2014. Ky raport pasqyron një pasqyrë transparente dhe reale e cila përputhet edhe me sistemin SMFK të MF dhe raportet që i bëjmë në ministri. Sa i përket të hyrave vetanake këtu që i kemi prezantuara, nuk janë të përfshira të hyrët nga gjobat e gjykatës. Të hyrat e realizuara për 6 mujor pa gjobat e gjykatës për vitin 2015 kemi në vlerë prej 373,816.53 € dhe nëse i krahasojmë me periudhën e njëjtë të vitit të kaluar shihet që kemi një zvogëlim, ky zvogëlim në përqindje më të madhe është tek tatimi në pronë, rreth 20,000.00 € e që ka ardhur si pasojë e asaj që ka iniciuar MF i cili tash është në draft ligj është aprovuar dhe shpresoj se shumë shpejtë do të formohet edhe ligji për faljen e borxheve. Kushti që është që secilit që i falet borxhi do të paguaj në mënyrë retroaktive borxhin që e ka nga 2009 e këndeje dhe besoj se kjo shumë do të inkasohet në periudhën e dytë të këtij viti dhe do të kemi realizimin e të hyrave vetanake rreth 1,99,000.00 €. Sa i përket shfrytëzimit të buxhetit nëpër kategori te ndryshme ekonomike kemi këtë përqindje: për paga dhe mëditje kemi 50.75 %, mallra dhe shërbime 36.20 %, shpenzime komunale 52.32 %, subvencione dhe transfere për 6 muaj 41.47 %, shpenzime kapitale 40.48 %, dhe total buxheti për 6 mujorin e 2015 është shfrytëzuar në masën 46.48 %. Ka një shfrytëzim real të buxhetit pasi që

në investime kapitale periudha e parë e vitit është me më pak me pagesa se sa në periudhën e dytë të vitit. Sa i përket shfrytëzimit të mallrave dhe shërbimeve për të njëjtën periudhë i kemi pasqyruar në mënyrë detale për secilën drejtori. Duhet të kemi kujdes gjatë analizës sepse ne disa kategori ka ndryshime nga vitit paraprak sepse ende jemi duke u përball me faturat e vitit 2013, siç janë faturat e telefonit, faturat për shpërndarjen e tatimit në pronë nga posta dhe ne jemi duke paguar çdo muaj prej një afati 24 muajsh., të cilat shpenzime janë të reflektuara në disa drejtori si shpenzime të këtij viti, por realisht janë shpenzime të programuara të vitit 2013, 2012. Në fund e kemi edhe raportin e kontratave aktive për vitin 2013, 2014, 2015, dhe siç e shihni ende jemi duke i paguar kontratat e vitit 2013 dhe jemi duke i përcjellë punët e vitit 2013 dhe janë shumë kontrata që edhe me buxhetin e vitit 2015 nuk do të mundë të përfshihen dhe të paguhen të gjitha. Po ashtu i kemi prezantuar edhe faturat të cilat janë prezantuar në fund të vitit 2013, 2014 dhe faturat të cilat i kemi prezantuar me 30.06.2015 ku shihet se ka një zvogëlim dhe një stabilitet të pagesave në të gjitha kategoritë.

Fatmir Iska – Drejtori e elaboroi këtë raport 6 mujor, por nuk do të thotë se qëndron gjithçka ashtu si thotë ai, do të mundohem të jap kontributin tim në këtë drejtim. Faqe 4 tab. 1, plani i të hyrave për Komunën e Rahovecit është diku rreth 1,100,000.00 €, të realizuara për 2015 për 6 mujorin e parë kemi 373,816.00 € pa gjokat e gjykatave dhe të trafikut dhe në krahasim me vitin 2014 kemi 30,000.00 € më pak të hyra. Ndërsa në raport me planin 2015 në 6 mujorin që e ndajnë këtë 1,100,000.00 € kemi më pak 176,000.00 €. Pra kemi një inkasim shumë të vogël dhe nëse shkojmë me këtë trend si deri më tani do të kemi diku afër 300,000.00 € më pak të hyra. Në faqen 6 tabela 4 krahasimi i të hyrave nga gjokat e trafikut me gjokat e gjykatave, këtu janë të pasqyruara vetëm gjokat e trafikut dhe prapë kemi diku 3,000.00 € më pak nga 2014, por kjo besoj se lidhet me shumë me polici dhe më pak me ekzekutiv. Faqja 7 janë të pasqyruara kodet që janë realizuar të hyrat, drejtori e përmendi ligjin për falje që ndikon vetëm tek tatimi në pronë dhe kemi afër 20,000.00 € më pak, por unë nuk besoj se është vetëm një problem por ka edhe shumë probleme tjera. Tek regjistrimi i pronës kodi 511 kemi minus 5,000.00 €. Tek kodi 512 kemi plus 5,200.00 € dhe kjo është shumë mirë, pra ne japim edhe pozitivitetin e asaj se ku është mirë. Kodi 529 taksa për ushtrimin e veprimtarisë kemi minus 8,556.00 €. Tek shfrytëzimi i pronës publike kemi një ngritje prej 5,822.00 € kjo është shumë mirë. Kodi 50 407 qiraja vendosja e objekteve tregtare kemi minus 4,455.00 €, pra kërkojmë sqarime se pse ndodhin këto minuse kaq të mëdha. Por minusi ma i madh është edhe tek inspektimi i planit urbanistik ku kemi minus 9,903.00 €. Tek faqe numër 16 që lidhet me faqen 17 dhe 18 kemi tabelorin 9 raporti i krahasimit 6 mujor 2014 – 2015 për mallra dhe shërbime, tek kodi i parë 13 133/43 kemi mëditjet e udhëtimit në 2015 janë 12,800.00 € ndërsa në 2014 kemi pas 9,643.00 €, edhe pse kemi rritje të luksit dhe të mëditjeve në tabelar e hasa se vetëm drejtoria e arsimit nga kjo shumë që e ceka më lartë i ka shpenzuar 8,000.00 €. Kërkoj shpjegim se pse ka ndodhur kjo apo është ndonjë bartje e mjeteve nga drejtorit tjera. Tek shpenzimet e telefonit dhe të internetit kemi rritje prej 1,600.00 € në krahasim me vitin 2014. Tek kodi 13 460 shërbimet e kontraktuara tjera në 2015 kemi shumën rreth 45,000.00 €, ndërsa në 2014 po në të njëjtin kod kemi pas një rritje prej 10,500.00 €, sa e di unë edhe ashtu administrata është tepër e ngarkuar nuk e di se sa kemi nevojë në kontratë mbi vepër. Tek kodi 13 640 në faqen 17 në 2015 kemi 7,605.00 € në 2014 4,800.00 € prapë këtu kemi një rritje prej 2,800.00 €. Tek kodi 13 720 naftë për ngrohje në 2015 kemi 27,984.00 € ndërsa në 2014 kemi 17,464.00 €, pra kemi një rritje diku rreth 10,520.00 €, a janë këto fatura të paguara nga vitet e kaluara sepse nuk kemi nevojë në këto ditë të nxehta naftë për ngrohje. Po ashtu edhe kodi 13 760 dru për ngrohje ku në 2015 kemi ma shumë 2,700.00 € se në vitin 2014. Tek karburantet për vetura kodi 13 780 më vije shumë mirë që kemi një zbritje prej 9,000.00 €. Po ashtu edhe tek riparimi dhe mirëmbajtja e automjeteve kemi 3,000.00 € më pak se në vitin 2014 edhe kjo është për tu lavdëruar. Por tek mirëmbajtja e ndërtesës kemi 9,020.00 € ma shumë se në vitin 2014, si dhe tek mirëmbajtja e shkollave 6,200.00 € ma shumë se në 2014, pse është bërë kjo rritje. Tek faqja numër 18 kodi 14 050 kemi shpenzime vetëm në 2015 ndërsa në 2014 nuk kemi, kërkoj një shpjegim se çka është kjo. Tek botimet publikime kemi rritje nga 2014 plus 3,000.00 €. Tek drekat zyrtare në krahasim me 2014 kemi më pak 6,332.00 €, mirëpo nuk besoj se këtu janë futur shpenzimet e drekave zyrtare që komuna jonë organizon çdo vit me ditën e mësuesit “ 7 Marsin” po ashtu në muajin qershor dita e çlirimit po ashtu edhe aty shtrohet një darkë për familjarët e dëshmorëve, veteranët dhe invalidët e luftës. Rritja e shpenzimeve për mallra dhe shërbime nga 2014 në 2015 kemi rritje për 38,518.00 €. Kërkoj një shpjegim nga drejtori për të gjitha që i përmenda më lartë.

Përparim Krasniqi – Më intereson shuma 45,000.00 € tek shërbimet kontraktuale tjera, nëse e kalkulojmë brenda 6 muajve i bie 24 punëtorë me mesatare 300 € pagë në muaj. Pyetje ime tjetër është në lidhje me tatimin në pronë. Në bazë të statistikave çdo vit të njëjtat dokumente nxirren dhe si është e mundur që punëtorët e kuvendit komunal të lejojnë të nxirren dokumentet nga tatimi në pronë pa u paguar, dua ta di se a është urdhër nga drejtoria që mos të kërkohej pagesa e tatimit në pronë.

Flori Boshnjaku – Në lidhje me këtë raport financiar kemi biseduar edhe në KPF. Dua ti them drejtorit se nuk ka më arsye për borxhe të vitit 2013 janë harxhuar gjitha arsyetimet, ne nuk jemi fajtor që nuk po munden ti mbledhin të hyrat vetanake. Faqja 7 shfrytëzimi i pronës publike nga 7,000.00 € në 13,000.00 €, ne e dimë se ju kemi falur borxhet shfrytëzuesve të lokaleve të komunës, por dua ta di se a i kanë paguar borxhet që i kanë pas për obligim, ky është muaji i fundit ku ata duhet të paguajnë të gjitha obligimet. Kam kërkuar në KPF edhe tash prapë po kërkoj që tek mallrat dhe shërbimet e Kuvendit komunal në faqe 11 ku thotë kanë shpenzuar 6,544.99 €, kam kërkuar një sqarim në KPF por kryesuesi ka than se ne mbledhje të kuvendit drejtori do të na jep një sqarim. Tek Drejtoria për Kulturë

Rini dhe Sport thuhet se mbi 9,000.00 € ka shpenzuar mallra dhe shërbime. Nuk e kam të qartë çka ka mundur kjo drejtori të shpenzoj kaq shumë mallra dhe shërbime. Tek furnizimi me higjienë ne e dimë se shërbimin e higjienës e kemi qar në privatizim, ndërsa këtu thuhet se mbi 7,000.00 € janë shpenzuar në këtë vit.

Azbi Gashi – Tek faqja 14 pagesa e qirasë ku thuhet se për vitin 2014 shuma e pagesës është 2,540.00 €, ndërsa në total thuhet 2,640.00 € dua një sqarim mos është bërë ndonjë gabim gjatë llogaritjes. Tek faqja 15 regjistrimi dhe sigurimi i automjeteve, dua ta di se pse në vitin 2015 tek drejtorja e kadastrës 689.00 € është bërë pagesa për sigurim të automjeteve ndërsa për regjistrim jo. Tek QKMF-ja 75 € ka regjistrim të automjeteve ndërsa 1053.00 € ka sigurim. Po ashtu tek drejtorja e kulturës sigurim ka 187 € ndërsa regjistrim nuk ka, dua një shpjegim rreth kësaj.

Rukije Krasniqi – Së pari e kam një vërejtje për materialin e raportit financiar teksti që është shënuar nuk është shënuar me shkronja të njëjtë me madhësi 12, por me madhësi të ndryshëm që nga 8 deri 16, po kemi problem që ta lexojmë sepse po ashtu janë bërë më hijezim, tekstet zyrtare nuk duhet të hijezohen sepse paraqesin vështirësi gjatë leximit. Tek faqe 20 raporti vjetor për kontratat e nënshkruara publike e kam një vërejtje te pastrimi i mbeturinave të ngurta lokacioni Qëndresë, tenderin e ka marrë kompania Rexha sh.p.k nga Prishtina, por sa e di unë pastrimin e këtyre mbeturinave që e ka bërë kompania Dellova nga Krusha e Madhe i cili e ka marrë nga Nazim Veliu, a ka mundësi drejtori të na jep sqarime rreth kësaj.

Afrim Limani – Ajo çka e karakterizon këtë raport 6 mujor financiar është se ndoshta për herë të para është i kompletuar dhe i përfushin të gjitha ngjarjet dhe aktivitetet financiare që janë zhvilluar, mirëpo këtij raporti i mungon një e dhënë që unë vazhdimisht e kam kërkuar e ajo është të bëhet paraqitja e të hyrave vetanake sipas drejtorive. Drejtori nuk është akoma i vetëdijshëm se çfarë efekti ka paraqitja e të hyrave vetanake sipas drejtorive sepse secili drejtor mund ta shoh performancën e vet. Të hyrat vetanake nuk është obligim vetëm i ekzekutivit por është obligim edhe i asamblistëve. I kisha propozuar drejtorit që në pjesën hyrëse të raporti ta fshijë fjalinë paraqitja e raportit sipas drejtorive, sepse nuk është ashtu. Ky raport ka gabime të shumta teknike që më shtynë të dyshoj se a janë gabime teknike apo të qëllimshme. Shpresoj se në muajt e ardhshëm do të realizohen të hyrat vetanake sepse kjo paraqet një rrezik për realizimin e projekteve kapitale dhe sipas këtyre indikatorëve që i kemi në këtë raport diku afër 40 % të projekteve kapitale nuk do të mund të realizohen. Tek paraqitja e të hyrave analitike kemi një rrënjë të hyrave tek taksa për ushtrimin e veprimtarive prej 8,500.00 €. Këtu i kemi edhe regjistrimet e reja të tatimit në pronë dhe nëse e krahasojmë me vitin e kaluar kemi një rrënjë të dukshme të regjistrimeve të reja. Në vitin e kaluar i kemi pas 505 objekte ndërsa tani i kemi 111. Në prezantim të raportit vitin e kaluar figurojnë regjistrimet e reja 108 objekte e jo 505, pra ka mospërputhje të raportit të vitit të kaluar dhe raportit të këtij viti. Tek realizimi i buxhetit konsideroj se në masë në total 46 % është mirë. Tek kategoria e mallrave dhe shërbimeve, e kam bërë një krahasim me vitin e kaluar dhe në bazë përvojës sime që e kam gjitha këto shpenzime janë në masën brenda limitëve të caktuara dhe të lejuara me përjashtim tek shërbimet kontraktuale që janë një masë e konsiderueshme dhe konsideroj që në këtë pikë e kemi shkel edhe ligjin. Tek karburantet për gjenerator kodi 13 770 vitin e kaluar e ke prezantuar 5,987.14 € ndërsa në këtë 6 mujor 741 € që ka një dallim prej 5,245.00 €. Kodi 13 780 karburant për vetura vitin e kaluar i ke prezantuar 22,411.00 €, ndërsa tani 27,656.00 € që ka një dallim prej 5,000.00 €. Po ashtu edhe tek sigurimet e automjeteve vitin e kaluar i ke prezantuar 2,444.00 kurse tani 1,199.00 € ku ka një dallim prej 1,200.00 €. Ka mospërputhje edhe tek kodi 14 020 mirëmbajtja e ndërtesës ku kemi një dallim prej 1.000 €. po ashtu edhe tek drekat zyrtare vitin e kaluar i ke bërë prezantimin 6,229.00 € ndërsa në këtë vit 2,829.00 €, pra, ka dallime të theksuara në vlera. Tek raporti i prokurimit i kam dy pyetje? Tek kodi 007 intervenime emergjente në infrastrukturë ku kemi një pagesë prej 61,230.00 € më intereson se ku kanë shkuar këto pare dhe çka është punuar me këto para. Tjetra që më la përshtypje është tek kodi mirëmbajtja e parqeve varrezave të dëshmorëve dhe varrezat në komunën e Rahovecit, e ka marrë një operator nga Vushtrria, besoj se të njëjtën punë kanë mundur ta kryejnë edhe operatorët e komunës tonë. Po ashtu edhe pastrimin e mbeturinave të ngurta në lokacionin e Qëndresës në Rahovec edhe këtu e kemi një operator jashtë komunës sonë edhe këto punë kanë mundur ta kryejnë operatorët nga komuna jonë.

Arsim Kastrati - Përhëndetje për të gjithë, desha të fokusohem tek realizimi i të hyrave të tatimit në pronë në faqe 10, ku për vitin 2015 është 152,000.00 €, ndërsa në faqe 7 figuron 150,000.00 € a është bërë ndonjë gabim teknik këtu apo si qëndron puna.

Lulzim Sylejmani – për realizimin e të hyrave, unë në fillim kur e lexova raportin e shpreha këtë si shqetësim tonin. Mos realizimi i të hyrave në masë të planifikuar është një tatimi në pronë, e dyta është vendimi që është nxjerrë nga kuvendi për falje të borxhit dhe afat prej 3 muajve pagesë. Edhe pse ligji mbi inkasimin e detyrueshëm ekziston, mirëpo përderisa nuk bëhet ligji për falje të borxheve i plotfuqishëm, ne nuk po mundemi ti inkasojmë në mënyrë të detyrueshme tatimin në pronë. Është shumë e vërtetë se ka disa kode që janë minus që i përmende. Tek regjistrimi i pronës kjo nuk varet prej komune por prej qytetarëve, aq sa ka kërkesa ne i përgjigjemi dhe i inkasojmë. Tek licencat e lokaleve është një diferencë e vogël sepse është bërë ndërrimi i dëftësave dhe janë hyrë diku tjetër. Tek taksat për ushtrimin e veprimtarisë kemi një zvogëlim të hyrave. Kemi një rritje tek shfrytëzimi i pronës publike si vendosja e trafikave etj. Tek inspektimi i respektimit të planit urban edhe këtu kemi një rrënjë të madhe por pas ligjit për legalizim dhe regjistrim të këtyre pronave kjo ka ndikuar që të bie sepse njerëzit presin që të kryhet e gjitha kjo dhe pastaj të fillojnë me marrje leje. Në total kemi një vlerë prej 30,000.00 më pak në krahasim me vitin e kaluar. Jemi mbrapa është shumë e vërtetë në krahasim me planifikimin, por shpresoj se në periudhën e dytë do të na ndihmojnë

edhe gjrobat e gjykatave dhe pagesat retroaktive e tatimit në pronë. Sa i përket shpenzimeve tek mallrat dhe shërbimet, Fatmiri edhe në KPF ka pyetur në lidhje me pagesën e mëditjeve tek Drejtoria e Arsimit, kjo pagesë është bërë për transportin e nxënësve që bëhet në disa lokacione për vajtje ardhje në sholla që regjistrohet në atë kod dhe kap vlerën prej 1,260.00 € në muaj. Keni pyetur për kontrata për shërbime të veçanta, ka qenë një staf i cili është angazhuar në drejtorin e urbanizmit për regjistrimin e legalizimeve. Kemi dy kontrata mbi vepër në tatim në pronë për shkak se dy persona kanë shkuar në pension dhe ne proceset duhet ti vazhdojmë, nuk mundemi ti lejmë vendet e thata, konkursi është duke u përsëritur që tre herë nuk e di se pse. Secili kod i përgjigjet drejtorisë së caktuar, ka disa kode që janë të përgjithshëm por kodet e taksave dhe të bizneseve e dimë se cilës drejtori i takojnë. Në raportin e radhës do i pasqyroj sepse është mundësia. Tek gabimet teknike qa pyetët për 6 mujorin e kaluar të vitit të kaluar, i kam dhanë arsyet në raportin 9 mujor dhe kemi kërkuar falje për gabimet teknike që kanë ndodhë. Por 6 mujori i vitit të kaluar që është prezantuar tani është real.

Afrim Limani - Jam shumë transparent dhe shumë i sinqertë, unë e them ashtu si e shoh gjendjen, me u ndalë tash unë me tregu se ku janë harxhuar mjetet se edhe unë i kam pas raportet e shpenzimeve të partisë tënde që kanë qenë në pushtet, por unë asnjëherë nuk e kam thënë, vetëm kam ecur përpara me punë dhe e kemi qitë trenin në binar.

Lulzim Sylejmani – Po kush po thotë se edhe ne nuk e kemi qitë trenin në binar, shikoje në faqen e fundit të raportit gjendjen si e keni lënë ju dhe si është tani. Unë e raportoj atë gjendje të cilën e shoh dhe deri sa të paguhet fatura e fundit e obligimeve që i keni lënë ju. Tek çështja e shpenzimeve të Drejtorisë së Kulturës është drejtori prezent këtu për të ju përgjigjur, ndërsa tek mallrat dhe shërbimet ka ndonjë arsye se pse është ajo vlerë unë për momentin nuk mundem me elaboru në mënyrë detale këtë shpenzim. Arsimi ka pyetur për realizimin në pronë. Një raporte nxirret nga sistemi i tatimit në pronë që është përgjegjës menaxheri, ndërsa raporti tjetër nxirret nga zyrtari i thesarit dhe ai raporte nuk përputhet me një datë, njëri me tjetrin, ato barazohen kur bëhet barazimi vjetor. Azbiu pyeti se pse diku ka regjistrim e diku ka vetëm sigurim. Disa sigurime janë të vitit 2013, 2014 dhe janë paguar për ato sigurime që i kanë mbetur borxh kompanive të sigurimeve, regjistrim nuk ka pasur.

Avdullah Kryeziu – Monitorimin e taksave afariste dhe qirave komunale e bënë Drejtoria për Ekonomi, Zhvillim dhe Turizëm, ne gjithë drejtorët e drejtorive i kemi raportet mujore dhe 6 mujore. Të hyrat i kemi në përputhshmëri me Drejtorin e Financave. Mund të vonohet ndonjë pagesë dhe nuk pasqyrohet në Drejtorin për Financa. Fatmiri Pyeti se taksat në biznes janë më paguar 8,556.00 € kjo vlerë nuk është por janë 7,836.00 €. Ngarkesa për vitin 2015 tek bizneset është 157,296.00 €, saldoja e viteve të kaluara është 711,474.00 €, borxhi total i subjekteve afariste i fillim vitit 2015 është 868,770.00 €, pagesat totale deri në muajin 6 të 2015 në vlerë 43,247.00 €, planifikimi për vitin 2015 është 100,000.00 €. Pra objektivi është realizuar diku 43.3 %. Po pse tash kemi më pak, ju si kuvendarë e keni miratuar një rregullore në kuvend në janar 2015, ku thuhet se lirohen të gjitha bizneset e regjistruara për vitin fiskal 2015 për 10 % në veprimtarin e parë, në të dytën 20 %, të tretën 30 % dhe në të katërtën 40 %. Pra shumë e lirimit që ju është bërë bizneseve kap afër 16,000.00 €. Florija ka pyetur për vendimin e Kuvendit Komunal për lirimin e subjekteve afariste, vendimi është marr në fund të muajit prill. Në pikën 7 thuhet se ky vendim hynë në fuqi 15 ditë pas shqyrtimit të ligjshmërisë nga ana e MAPL-së. Ne kemi pritur përgjigjen nga MAPL dhe ajo na ka ardhur me vonesë, pra pas 30 dite dhe tani vendimi është i ligjshëm. Pra të gjitha këto subjekte e kanë afatin në muajin gushtë për ti paguar obligimet. Disa prej tyre i kanë kryer unë kam raportin. Saldoja e vitit të kaluar me borxhe ka qenë 64,664.00 €, vendimi është marr që të shlyhen 50 % dhe kanë mbetur 32,332.00 €, pagesat deri më tani janë bërë 13,000.00 € dhe kanë mbetur pa paguar edhe 19,000.00.

Fehmi Hoxha - Drejtoria e Urbanizmit taksa për leje ndërtimore ka pasur 1,763.00 € për 2014, ndërsa për vitin 2015 ka 3,351.00 €. Nuk e di se ku kanë shkuar edhe 2,654.00 € prej sektorit të mjedisit që faktikisht ka rritje. Aktualisht leje ndërtimore që janë të nënshkruara vlera e tyre është 3,270.00 € nuk kanë ardhur ende me i mare. Të lëshuar janë 26 kushte ndërtimore ku në mesatare për m2 1.7 € duhet të ketë diku edhe 11,200.00 €, kur ti mbledhim krejt këto do të kemi një rritje bukur të madhe. Deri në fund të vitit ju garantoj se 100 % do të arrijmë si drejtori e urbanizmit. Pyetje tjetër ishte për punëtorët me shërbime të veçanta. Komuna e Rahovecit e ka themeluar zyrën legalizimit në bazë të ligjit për legalizimin e ndërtimeve pa leje, dhe mendësia e pagesës së këtyre punëtorëve ka qenë vetëm përmes shërbimeve të veçanta, pasi që MMPH si sponsorizuese e atij ligji nuk ka paraparë fare fondin shtesë për pagesën e punëtorëve në tërë territorin e Kosovës. Me këtë problem janë përballur gjitha komunat, ne e kemi bërë kontratat 6 mujore aq sa e lejon edhe ligji, shpresojmë se do të vije një vendim në nivel vendi që ti vazhdohet kontratat sepse momentalisht vetëm zyra e Prishtinës vazhdon të jetë aktive tjerat janë të mbyllura.

Florije Boshnjaku - Sa punëtorë kanë qenë, sa muaj kanë punuar dhe sa i kanë pasur pagat.

Fehmi Hoxha – Për këtë vite 6 punëtorë janë të punësuar, njëri prej tyre e ka pagën 320 €, tjerët nga 295 €, në muaj neve si drejtori na kushtojnë këta punëtor 1.800 €, janë paguar për vetëm 6 muaj.

Kryesuesi - Tek çështja e tatimit në pronë kam një pyetje? A është duke u respektuar kushtëzimi që del në bazë të ligjit mbi tatimin në pronë dhe vendimit të kuvendit edhe për taksa komunale.

Lulzim Sylejmani -- Kushtëzimi është vetëm për regjistrim të veturave dhe ne vitin e kaluar atë arritje të inkasimit e kemi pas si rregull të brendshme që e kemi kërkuar faturën e vitit plus 10 % të borxhit të vjetër, ndërsa këtë vite nuk po mundemi ta kërkojmë borxhin por vetëm pagesat e faturave.

Kryesuesi - Falënderoj Drejtorin për këtë shpjegim të Raportit financiar 6 mujor dhe juve këshilltar pyetjet që i keni bërë. E qesë në aprovime këtë Raport Financiar 6 mujor: Konstatohet se me 8 abstenime, asnjë kundër dhe të tjerët pro është aprovuar Raporti Financiar 6 mujor.

3. Shqyrtimi dhe aprovimi i propozim Vendimit sipas kërkesës të Këshillit të fshatit Hoçë e Madhe për shpalljen e pavlefshme të Vendimit 01 Nr.125/07 të datës 26.06.2007,

Këtu kemi të bëjmë me një vendim që komuna në vitin 2007 ja ka ndarë një pronë personit që ju e keni emrin në vendim për ndërtimin e shtëpisë, me afat prej 10 viteve sipas ligjit që ka qenë në fuqi në atë kohë. Në vendim është precizuar nëse personi brenda 3 viteve nuk e arin të ndërtoj shtëpinë prona i kthehet Komunës. Meqenëse ky person nuk e ka përmbush obligimin, Këshilli i fshatit të Hoçës së Madhe e ka bërë një kërkesë që ky vendim të shfuqizohet dhe prona ti kthehet prapë komunës. Ky propozim vendim ka kaluar edhe në KPF. E qesë në votim këtë propozim vendim: Konstatohet se në mënyrë unanime është aprovuar pika e 3 e rendit të ditës.

4. Shqyrtimi dhe aprovimi i Raportit të punës dhe financiar për përdhën e sezonit pranveror të klubeve në komunën e Rahovecit,

Osman Hasku – Drejtoria për Rini, Kulturë dhe sporte në mbledhjen e mbajtur me 28.02.2015 me rekomandim të Kryetarit të Komunës ka dalë me një kërkesë në kuvend për ndarje të subvencioneve sipas rregullores në fuqi. Në këtë rast përfituesit e subvencioneve janë: KF “Rahoveci” Rahovec me 15,000.00 €, SH.K.A. “Bajram Curri” Krushe të Madhe 5,000.00 €, KF “18 Korriku” Fortesë 4,000.00 €, KB “Rahoveci” Rahovec me 2,500.00 €. Pas kësaj janë ndjekur procedurat e nënshkrimit të marrëveshjes në mes të Kryetarit të Komunës dhe udhëheqësve të klubeve dhe drejtoria për financa është obliguar këto marrëveshje t’i zbatoj. Sipas procedimit të kësaj marrëveshje deri më tani KF “Rahoveci” i janë ndarë 8,500.00 €, KF “18 Korriku” 1,400.00 €, SH.K.A “Bajram Curri” 2,000 € dhe KB “Rahoveci” 1.000 €. Ne i kemi raportet të cilat i kanë dorëzuar këta përfitues të subvencioneve dhe faktikisht shumica e tyre po përputhen me kërkesat e tyre.

Bahtjar Hoti – Për këto aktivitetet rinore dhe për këto shoqëri kulturo artistike nuk është në rregull me këtë shumë kaq të vogël të i ndahet, e pamë pak ma parë se sa shpenzime të kota janë bërë për telefona dhe mëditje. Kisha pas një kërkesë që për aktivitetet të rinisë të ndahen shumat pak më të larta.

Kadri Dellova – Kam një pyetje për Drejtorin e Kulturës, në fund të kampionatit Futbollistik të Kosovës KF “Rahoveci” është përballur edhe me vështirësi të ushqimit, besoj se nuk është mirë që në të gjitha mediat si ato lokale dhe tjera që KF “Rahoveci” nuk ka as bukë të hajë kur ne si komunë ja kemi ndarë 15,000.00 €. Dua ta di arsyen se pse kjo kështu ndodh. Drejtor propozoj që së paku në sezonin e dytë që në fillim ti ndahen mjetet.

Kryesuesi - Unë kam parë këtu që ka fatura pa nënshkrim fare dhe pa kupon fiskal dhe e kanë barazuar gjendjen, nuk e di se si i ka pranuar këto fatura kështu drejtori. Dikush aty është duke i keqpërdorur këto para, por jam i bindur se lojtarët jo kurrësi. Kërkoj që në të ardhmen asnjë faturë të mos pranohet pa u verifikuar. Falënderoj drejtorin për prezantimin e raportit të punës dhe financiar të klubeve dhe shoqatave para kuvendit dhe në të ardhmen është mirë që të gjithë ata që marrin subvencione prej komunës t’i arsyetojnë se ku janë duke i shpenzuar ato para.

Afrim Limani – Në rendin e ditës shkruan shqyrtimi dhe aprovimi i raportit të punës dhe financiar për periudhën e sezonit pranveror, pyetja ime është se a kemi ne të drejtë që t’i kërkojmë edhe raportin e punës së këtyre përfituesve të subvencioneve apo vetëm raportin financiar. Neve na intereson më shumë raporti financiar dhe këtu kemi të dhëna të pakta për shpenzimin e drejtë të parasë. Kam vërejtur në disa raporte se i mungon edhe ana profesionale e raportimit ose e prezantimit. Kam vërejtur tek raporti i SH.K.A “Bajram Curri” mungesën e raportit të mirëfilltë financiar se ku janë shpenzuar këto mjete. P.sh. thotë: Shpenzimet e udhëtimit të anëtarëve 810 €, mëditje për instrumentistët, pastaj shërbime dhe mallra 859 €, sa e di edhe këto dy shpenzime tjera që i lexova bëjnë pjesë në mallra dhe shërbime, pra drejtori duhet të jep një model dhe të tregoj se çka duhet të precizohet.

Selim Duraku – Nuk është vetëm ky raporte që e ceku Afrimi i mangët, por të gjitha janë të mangëta, po ashtu e ceku edhe kryesuesi të KF “Rahoveci” - mëditjet e udhëtimit. Pra nuk janë të shënuara shpenzimet në mënyrë të mirëfilltë.

Florije Boshnjaku – Falënderoj Drejtorin e Kulturës që na e ka sjell këtë raporte në Kuvend sepse për ne janë shumë me rëndësi se ku shkojnë dhe si shpenzohen subvencionet. Subvencione nuk ka vetëm Drejtoria e Kulturës por janë diku 150,000.00 €. Shuma që ju është ndarë këtyre klubeve a është pak a shumë kjo varet se sa subvencione ka komuna. Propozoj që në të ardhmen ato mjete që ndahen nga ana e kuvendit mbi 1.000 € të na informojnë sikurse që na ka njoftuar sot drejtori i kulturës.

Nënkryetari – Më së shumti më la përshtypje diskutimi i Bahtjarit dhe plotësisht pajtohem dhe duhet të gjithë të pajtohemi, sepse të gjithë gjatë fushatave dalim me premtime të plota për rini kulturë dhe sport. Mirëpo, apriori në mënyrë hipotetike jeni duke i qitë pikë disa gjërave të cilat nuk është mirë dhe nuk është ashtu. Për herë të parë në historinë e komunës së Rahovecit kanë ardhur raportet nga klubet dhe nga shoqëritë kulturo artistike. Ka mangësi, nuk është perfektë, por e kemi shoqërinë në përgjithësi të mangët dhe duhet të shkoj edhe kjo ashtu. Shikoni se si bëhet pagesa e referëve, është tarifa të cilën e ka Federata e Futbollit të Kosovës, por mangësia e shoqërisë tonë është se në vend t’i paguhet Federatës së Futbollit të Kosovës mjetet për referimet, ne duhet ti paguajmë referet me para kesh në dorë pa vulë vetëm me një nënshkrim të kryereferit. Pra, ne nuk kemi rrugëdalje tjetër përveç kësaj mënyre për ti paguar. Të gjitha ata njerëz që merren me kulturë, sport dhe rini janë vullnetarë dhe më shumë janë duke dhënë nga vetja se sa që janë duke marr. Pra me 15,000.00 € nuk mundet asgjë të bëjë një klub për një sezone, sepse ku janë

lojtarët që duhet paguar, veshjet, referat, udhëtimet e shumë gjëra tjerë. Unë nuk isha lëshuar dhe të them se janë keqpërdorë mjetet, nëse dyshoni jemi kuvend kemi auditorin e brendshëm dhe le të bëjë auditimin.

Fatmir Iska – Po ashtu edhe unë pajtohem me Bahtjarin me të gjitha që i tha, por assesi nuk mundem të pajtohem me Nënkrjetarin i cili thotë se ka mjete pak, sepse nëse janë pak atëherë pse nuk janë duke i ndarë ma shumë ngase keni bërë goxha premtime, dhe vetëm ato premtime që i keni bërë realizoni dhe drejtori do të del pastaj faqe bardhë. Drejtor faleminderit për raportin është një raporte i mirë, ka disa mangësi të faturave por nuk munden të gjitha ndoshta ti paraqesin. Neve na ka mbetur së bashku me ekzekutivin që në të ardhmen ti risim këto subvencione.

Osman Hasku - Faleminderit edhe për kritikën edhe për lëvdatat dhe mbështetjet, tani është duke u hartuar buxheti dhe për vitin e ardhshëm mos më lini me 30,000.00€ sepse me këto nuk mundesh të bësh asgjë. Komuna e Therandës i ka 85,000.00 € subvencione për Kulturë, Rini dhe Sport për një vite kalendarik, unë nuk po them që edhe ne të kemi një shumë aq të madhe por së paku ti afrohem nevojave fundamentale. Z. Kadri vështirësi për KF "Rahovecin " unë nuk jam përgjegjës për çdo njëri që ta qetë emrin në gazet e pastaj tërhiqet nga deklarata dhe të kërkon falje privatisht sepse publikisht nuk ka guxim, ky nuk është problemi im por është problem i menaxhimit të mangët të KF Rahovecit.. Këto raporte që sot unë ju kam prezantuar e di se kanë mangësi të shumta por ju kisha lutur që ta autorizojmë auditorin që së paku llogaridhënien ta kemi në një nivel të caktuar. Subvencionet nuk janë mjete të cilat shpenzohen për myzhde, por janë mjete të cilat kërkojnë llogaridhënie. Pajtohem me Afrimin që ta dëshmojnë edhe raportin e punës.

Kryesuesi – E qesë në aprovim Raportin të punës dhe financiar për përdhën e sezonit pranveror të klubeve në komunën e Rahovecit: Konstatohet se në mënyrë unanime është aprovuar pika e 4 e rendit të ditës.

5. Raporti i Komisionit Komunal për zgjedhjen e Këshillave dhe Kryetarëve të fshatrave, vendbanimeve të lagjeve urbane në komunën e Rahovecit.

Rasim Fazliu – Komisioni komunal për zgjedhjen e këshillave të fshatrave, vendbanimeve dhe lagjeve urbane e kanë kryer punë në mënyrë sa më të mirë të mundshme në bazë të rregullores së datës 28.08.2014. Ne si komision jemi takuar disa herë, në bashkëpunim me DEMOS-in Zviceran e kemi caktuar agjendën dhe detyrat cilat duhet të kryhen gjatë zgjedhjes së këshillave dhe kryetarëve të fshatit dhe lagjeve urbane. E falënderoj komisionin komunal i cili me të vërtet ka qenë shumë efikas dhe unik dhe në shumicën e rasteve kemi qenë prezent të gjithë. Ky komision ka qenë i përbërë prej 3 anëtarëve të kuvendit, nga tre parti më të mëdha, 2 nga ekzekutivi, 1 anëtar nga KDI -ja dhe 1 anëtar ka qenë prezent në çdo fshat cilin kemi marr pjesë. Ne e kemi caktuar agjendën që zgjedhja e kryetarëve të fshatrave dhe lagjeve urbane të kryhen në vitin 2014, mirëpo me kërkesën DEMOS-it ne zgjedhjet i kemi mbajtur në vitin 2015 sepse ata nuk kanë mundur të marrin pjesë në vitin 2014, për arsye se kanë qenë të ngarkuar me punë diku tjetër. Në mars të vitit 2015 shumicën e zgjedhjeve të kryetarëve dhe lagjeve urbane i kemi kryer, me përjashtim 2 ose 3 lokaliteteve që janë kryer në muajin Prill. Ne ju shpërndamë pak më parë procesverbalin e mbledhjeve aty janë të paraqitura të gjitha gjërat që i ka lypur ky organizim, po ashtu aty i keni të gjitha emrat e kryetarëve të fshatrave dhe lagjeve urbane që janë zgjedhur.

Selim Duraku – Me të vërtet këta anëtar të komisionit për zgjedhjen e kryetarëve të fshatrave dhe lagjeve e kanë pas një punë të vështirë. Dua të ndalem tek rregullorja të cilën nuk e di se kush e ka nxjerrë Komuna apo DEMOSI, sa ka qenë kriteri minimal i pjesëmarrjes së votimit të një kryetari të fshatit ose lagjes.

Rasim Fazliu – Në bazë të rregullores të Kuvendit Komunal dhe një udhëzuesi që na ka dhanë DEMOSI parashihet që: Këshillat e fshatrave të kenë 3,5,7 anëtarë dhe thuhet se nëse në një fshat ose lagje të qytetit është 3 me 1 proporcioni, pra nëse vetëm 9 persona kanë qenë prezent në një vendbanim kanë pas të drejtë të zgjedhin këshillin prej 3 anëtarëve, nëse kanë qenë 15 persona prezent kanë pas të drejtë të zgjedhin një këshill prej 5 anëtarëve, 21 persona prezent 7 anëtarëve etj.

Flori Boshnjaku – Më vjen mirë që propozimi im që e kam propozuar në KPF për raportim të komisioneve veç ka filluar, falënderoj anëtarët e komisionit për punën e bërë sepse me të vërtet e kanë kryer një punë shumë të lodhshme dhe të mundimshme, por besoj se në fund është kryer me sukses. Kam disa propozime ose sugjerime, së pari ky raport duhet të shënoj se kujt është duke ju drejtuar, nga cili komision drejtohet. Propozimi tjetër është se duhet të shënohet : Raporti i komisionit komunal për zgjedhjen e këshillave lokale, e jo këshillave të fshatit si e keni paraqitur ju. Po ashtu është mirë që secili anëtar i komisionit që keni qenë të nënshkruaj që janë pajtuar me këtë zgjedhje.

Bahtjar Hoti – Nuk jam duke e kuptuar në Hoçë të Madhe kush është Kryetar sepse këtu ky dy emra.

Rasim Fazliu – Ne në Hoçë të Madhe zgjedhjen e kryetarit e kemi kryer në vitin 2014 dhe është zgjedhur në atë kohë për kryetar fshati Bojan Pavloviç, pastaj kur është mbajtur këshilli për Hoçë të Madhe ky person ka kaluar në këtë këshill dhe vetë qytetarët e Hoçës e kanë zëvendësuar me Negovan Mavriç.

Në bazë të rregullores të Kuvendit Komunal kemi thanë që 30 % duhet të jetë e përfshirë gjinia femërore. E kam cekur në raport se meritë ka fshati Ratkoc sepse kanë qenë prezentë diku 70 femra që kanë votuar, ndërsa në fshatra tjerë dhe as në lagjet e as në qytet nuk ka pasur asnjë femër prezentë.

Kryesuesi - Falënderoj komisionin komunal për zgjedhjen e këshillave të fshatrave dhe lagjeve urbane, po ashtu falënderoj DOMOS-in i cili i ka dhënë një përkrahje dhe mbështetje edhe në sensibilizimin e opinionit të qytetarëve që të marrin pjesë sa më shumë në këto zgjedhje. E qesë në votime edhe këtë raport: Konstatohet se në mënyrë unanime është aprovuar raporti i komisionit për zgjedhjen e kryetarëve të fshatrave dhe lagjeve urbane.

Rasim Fazliu - Ne kemi marr zotim si nga ju ashtu edhe nga Kryetari i komunës që komisionet të cilët e kryen punën duhet të paguhen, dhe në bazë të premtimeve unë sot këtu e kam sjell raportin. Kërkoj që ky kuvend sot të merë një vendim që komisionet të cilët e kryejnë punën dhe bëjnë raportimin në kuvend të paguhen. Ne jemi përcaktuar ma herët që 30 € të jetë pagesa për anëtar të komisionit.

Kryesuesi - Ne kemi një buxhet për Mallra dhe Shërbime dhe mëditje, nga ana ime është gjithë në rregull, unë jam që të gjitha komisionet të paguhen por sa janë mundësitë financiare për me ju paguar është këtu Drejtori i Financave sepse unë nuk e menaxhoj financat. Në mbledhjen e radhës është mirë që të na vije një raporte nga ana e financave të shikojmë se si është gjendja e financave dhe si është gjendja e mos pagesave të të gjitha komisioneve.

Rasim Fazliu - Neve si komision nuk na intereson se a ka para komuna, për të funksionuar ashtu si duhet dhe komisionet duhet të paguhen për punën e vet. Ministri i Financave ka thanë qartë 150 % paguhen ata që punojnë jashtë orarit të punës. Dua t'ju kujtoj se disa nga anëtarët e komisionit edhe me vetura personale dhe me shpenzimet e tyre kanë ardhur nga një fshat në fshatin tjetër dhe tani të mos kompensohet nuk është e drejtë.

Lulzim Sylejmani - Komisionet që paguhen nga pagat dhe mëditjet e kuvendit janë Komiteti për Komunitete dhe KPF, tek pozicioni pagat dhe mëditjet asnjë komision nuk paguhet dhe as që është e paraparë dhe nuk ka mjete për të paguar nga ky pozicion. Ky komision që po flitni tash të vetmen mundësi e ka që të paguhet nga mallrat dhe shërbimet, por edhe këtu nuk është e lejuar me ligj, por nëse ky kuvend nxjerr vendim që të bëhet pagesa nga mallrat dhe shërbimet, le të bëjë shkelje kuvendi. Por në vendim duhet të ceket kështu: Komisioni për zgjedhjen e këshillave të fshatrave dhe qytet të paguhet nga mallrat dhe shërbimet e kuvendi dhe ne si drejtori do të aprovojmë, por duhet ta dini se është shkelje e Ligjit për financa publike.

Bahtjar Hoti - Meqë u miratua nga Kuvendi Raporti i komisionit për formimin e këshillave të fshatit dhe lagjeve urbane, ne e kemi pas në mbledhjen e kaluar një kërkesë nga kryetarët e fshatrave që ta kenë një vendim nga Kuvendi Komunal që janë mandatar të kësaj periudhe dhe është mirë që të legjitimohen. Sa i përket asaj se a ka financa me i paguar komisionet këtu është nënkryetari dhe ne kur e kemi formuar komisionin për emërtimin e rrugëve dhe rrugicave këtu në kuvend nuk është diskutuar çështja e mëditjeve se a do të jetë 30 € ose 50 € por është diskutuar se duhet paguar, ndërsa në mbledhjen e komisionit është caktuar mëditja. Pra nëse nuk ka pas mjete nuk është dashur të caktohet as mëditja, pse jeni duke i bërë këto mashtrime.

Kryesuesi - Në bazë të këtij raporti që sot është aprovuar Kryetari i Komunës i lëshon vendimet të gjithë kryetarëve të fshatrave dhe lagjeve urbane. Pra zyrtarisht ata prej kësaj dite janë kryetar.

Rukije Krasniqi - Sipas teje kryesues deri më sot ata kanë punuar ilegalisht, kryesues puna jonë ka qenë legale dhe jo ilegale, pra ata në momentin e zgjedhjes si kryetar fshati ose lagje kanë qenë legjitim. Po ashtu në vitin 2014 ne kemi marrë vendim për formimin e komisioneve dhe për pagesa, gjithashtu kemi pas propozime për mëditje njëri propozim ka qenë 50 € tjetri 25 € dhe si mesatare e kemi nxjerrë që të paguhen 30 € komisionet të cilat formohen nga ana e kuvendit. Për pagesat e atyre me kontratë mbi vepër paska pas mjete ndërsa për komisionet që i kanë kryer punët nuk ka mjete.

Qazim Qeska - Kuvendi kur e formon një komision është vendim i plotfuqishëm dhe anëtarët e komisioneve nuk duhet të diskriminohen sepse nuk ka askush të drejtë legjitime e as normative që anëtarët e komisionit të diskriminoj, pra të gjithë duhet të hyjnë në sistemin e pagesave.

Flori Boshnjaku - Kryesues ti ke deklaruar që ke biseduar me drejtorin e financave dhe duhet të paguhen anëtarët e komisionit, tash nuk e di se ku është problemi.

Fatmir Iska - Pajtohem edhe me z. Qeska dhe z. Fazliu, por çka do të bëhet më tutje çfarë veprime do të ndërmerren a do të paguhen ato komisione që janë formuar nga Kuvendi apo jo, a do të ndërmerren ndonjë veprim konkret apo vetëm në cilësi të debatit do mbetet kjo, kërkoj që të marrim një veprim konkret. Pasqyrën financiare je duke e lypë në çdo mbledhje nuk e di se pse nuk po ta sjellin.

Kryesuesi - Do të konsultohem edhe me Ministrin e Financave dhe nëse nuk është shkelje ligji të paguhen nga mallrat dhe shërbimet.

6. Pyetje dhe përgjigjet në pyetjet e këshilltarëve.

Besnik Hoti - Kam një pyetje Drejtorin Fetoshi në mungesë të tij i drejtohem Nënkryetarit, gati që një muaj në rrugët e qytetit të Rahovecit dhe në disa rrugë të fshatrave është bërë gërryerja e asfaltit dhe që një muaj ato rrugë kanë mbetur ashtu, kur do të bëhet mbushja e këtyre gropave. Pyetja tjetër është pse ka kaq reduktim të ujit të pijes, në disa fshatra të komunës brenda 24 orëve vetëm 4 orë ka ujë.

Rukije Krasniqi - Ujërat e zeza këto ditë janë duke u shfaqur nëpër vende afër shkollave dhe është duke kundërmuar një erë shumë e rëndë dhe mund të përhapet ndonjë epidemi, veçanërisht afër shkollës "Isa Boletni" rruga "Bujar Thaqi".

Ejup Kabashi - Kam një pyetje për Drejtorin Fetoshi për shkak të premtimeve që i ka bërë ai dhe më vjen keq që nuk është sot prezent sepse kam dashtë sot të ballafaqohem me argumente. Ka premtuar që vitin e kaluar do të kryhet rruga Reti - Optrushë dhe deri më tani asgjë nuk është bërë në atë rrugë. E dyta dua një sqarim, sot sapo mora një informacion nga Kryetari i fshatit se kompania e Radoniqit në fshatin Optrushë ka planifikuar të faturoj ujë në shumën prej 42 € për dy muaj për çdo familje, pa e bërë vlerësimin se kush sa ka shpenzuar. Është një revoltë nga fshatarët dhe kjo duhet sa ma parë të shqyrtohet. Kam po ashtu edhe një shqetësim, ne e dimë se kryetarët e fshatrave

janë të liruar nga pagesa për kërkesat që kanë të bëjnë me fshatin sepse ne kemi marr vendim në Kuvend, mua kryetari i fshatit më ka dëshmuar faturën që ka paguar për një kërkesë.

Fatmir Iska – Edhe në mbledhjen e kaluar e kam shtruar këtë pyetje për rrugët që janë katastrofale si ajo “Xhelal Hajda – Toni” dhe Gëzim Hamza – Piktori”. Janë dy rrugë të gjata përafërsisht 5 km dhe në çdo 100 m ka gropa. Drejtori në seancën e kaluar thotë menjëherë të nesërmen do të dalim për ti rregulluar, ndërsa kalon gati një muaj dhe ende asgjë nuk ka. Dua një sqarim pse nuk ka ndodhë ende kjo kur e dimë se kontrata është e nënshkruar që nga muaji Maj.

Përparim Krasniqi – Jemi duke u ballafaquar me një problem shumë të madhe këtë muaj me ujin e pijes, tash ka filluar edhe problemi i rrymës elektrike, është zakon se sa herë vijnë mërgimtarët të ndodhin këto. Pyetja tjetër e imja është a ka komuna ndonjë organizim për mërgimtarët.

Marigona Berisha – Dua të shpreh një shqetësim të banorëve të fshatit Hoçë e Vogël dhe shumë fshatrave të komunës sonë sa i përket ujit të pijes nga kompania e Radoniqit, çdo vite në sezonin e verës në kohën ma të nxehtë ne përballemi me reduktime të ujit të pijes. Ndodhë që 2 ose 3 ditë të mos vije fare. Sa e di tarifa prej 9 cent për m3 të cilën ja paguajnë qytetarët kësaj kompanie është e rregulluar nga rregullatori për ujë në nivel qendror. Drejtori i shërbimeve publike në mbledhjen e kaluar ka thanë se neve na mbetet që ti bëjmë presion kësaj kompanie që të ketë shërbime ma të mira. Pyetja ime është për Drejtorin Fetoshi, çfarë ka mundur të bëjë ai në këtë drejtim, a ka gjetur ndonjë zgjidhje për këtë problem që çdo vit po përsëritet.

Azbi Gashi – Në mbledhje të kaluar kam bërë pyetje, përgjigje nuk kam marr ende. Sot kam një pyetje për drejtorin e Ekonomisë dhe Turizmit. Ai ceku se ka raporte të detajuar, pyetja ime është tek falja e borxheve shfrytëzuesve që posedojnë lokalet komunale, sa është arrit dhe cilat janë ato firma që kanë bërë pagesën dhe sa është pagesa në total deri më tani.

Kadri Dellova – Pyetja ime është për Drejtoin e Financave: jemi dëshmitar që në kohën e fundit si në qytet ashtu edhe në fshatra shumë biznese që janë duke operuar me kafiteri dhe biznese tjera skajshmërisht janë duke uzurpuar pronën publike. Dua ta di se a paguajnë këta njerëz për m2 shtetit apo fare nuk paguajnë, besoj se koha ka ardhur që ta ndalim këtë dukuri.

Nënkryetari – Rreth pyetjes së reduktimit të ujit të pijes jemi të vetëdijshëm dhe kemi marr informacione nga Radoniqi, nuk është problemi që nuk ka ujë, mirëpo arsyeshmëria është e plotë, 460 L fabrika përpunon ujin nga liqeni, kapacitetin e ka ritë deri në 600 L, mirëpo momentalisht familjet që janë kyçur dhe shtimi i popullatës nuk mjaftojnë me pas ujë të mjaftueshëm në këtë stinë. Shqetësimi ynë është ky që e kemi përcjellë, e pranojmë se duhet të ketë reduktime por duhet të njoftohen qytetarët prej sa deri në sa do të ketë ujë, dhe cila lagje prej orës sa do të ketë ujë. Në pyetjen për ujërat e zeza që dalin jemi në dijeni dhe jemi shumë të shqetësuar, kemi biseduar me banorët që kanë oborre aty e kanë dhanë një pëlqim për tu futur në kanalizim dhe presim që të zgjidhet ky problem. Këto që e tha Ejupi është shqetësuese, ata ndoshta e kanë qitë edhe tarifën e kyçjes në sistem që është 35 €, por në këto raste nuk mundet dhe nuk ka të drejtë sepse ne kemi marrëveshje mirëkuptimi me kompaninë e Radoniqit. Unë këtë shqetësim do ta ngriti dhe do të kërkoj përgjigje nga kompania e Radoniqit. Gropat në rrugët e qytetit priten në muajin Korrik dhe Gushtë të kryhen sepse kontrata me operator është kontraktuar.

Kryesuesi – Muajin gushtë e shpalli si muaj të pushimit, por nëse pajtoheni ju që në funde të muajit me 31 gushtë ta mbajmë edhe një mbledhje të kuvendit por pa KPF për shkak se është muaji i pushimeve. Pra pajtoheni që me 31 Gushtë ta mbajmë edhe një mbledhje, do ta kemi raportin e auditorit besoj se drejtori i zhvillimit ekonomik do ta përgatisë raportin e komisionit vlerësues për ato 5 kamp shtëpiza tek Ura e Shenjt, ndoshta do të kemi edhe ndonjë pikë tjetër të rendit të ditës.

Faleminderit për pjesëmarrje dhe ju uroj pushime të këndshme, shihemi në mbledhjen e radhës.

Mbledhja e kuvendit ka përfunduar në ora 13.

Procesmbajtësi,
Fahredin Sharku

Kryesuesi,
Nahit Elshani

